



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 189 , Datë 19.11.2020

“MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“SEMAN SUNPOWER” SH.P.K., PËR TRANSFERIM TË ASETEVE (VENDOSJE
HIPOTEKË) NË FAVOR TË “INTESA SANPAOLO BANK” SH.A”.**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 20 pika “a”; nenit 44, pika “1”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” si dhe në zbatim të nenit 6; nenit 7 dhe nenit 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr.119, datë 21.07.2016, të ndryshuar; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Kushteve të Licencës” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016, gjithashtu dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 19.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 122/2 prot, datë 16.11.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për transferim të aseteve në favor të bankës “Intesa Sanpapolo Bank” sh.a.,

Konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1163 prot, datë 03.11.2020, shoqëria “Seman Sunpower” sh.p.k., ka paraqitur kërkesën për miratimin e transferimit të aseteve (vendosje hipoteke), në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.
- Shoqëria “Seman Sunpower” sh.p.k. në cilësinë e Mbajtësit të miratimit përfundimtar, në datën 29.12.2017, ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën me nr. 6299 Rep dhe 1598 Kol, “Kontratë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaiq “Topojë” me kapacitet 2000 kW; në zonën Sheq Marinas, Bashkinë Fier; Qarku Fier”.
- Me vendimin nr. 86, datë 20.04.2018, të Bordit të ERE-s, shoqëria “Seman Sunpower” sh.p.k. u licencua në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali fotovoltaiq Topojë

(Sheq Marinas) me kapacitet të instaluar 2000 kW dhe aktualisht mban Licencën me nr. 404 Seria PV18.

Aplikimi plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në *Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit* si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gërmat: “a”, “b”, “e”, “g”, janë plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 7, pika 1, gërma “c”, (gjendjen financiare të shoqërisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve). **Plotësuar pjesërisht**. Mungojnë pasqyrat financiare për periudhën kontabël 01.01.2019 – 31.12.2019, për të vlerësuar aktivitetin financiar të kësaj shoqërie, dokumentacion i cili duhet të depozitohet në ERE në vijim të këtij aplikimi.
- Neni 7, pika 1 gërma “d”, (një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferim aseti, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjëndjen financiare). **Pa plotësuar**. Shoqëria duhet të përcjellë dokumentacionin/informacionin e kërkuar nga kjo kërkesë e rregullores.
- Neni 7, pika 1, gërma “f”, (efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit). **Plotësuar pjesërisht**. Duke qenë se marrja e një huaje bankare lehtëson anën financiare të shoqërisë, i kërkohet shoqërisë të plotësojë këtë kërkesë të rregullores duke shpjeguar efektet pozitive të kësaj huaje.
- Neni 7, pika 1, gërma “h”, (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve). **Pa plotësuar**. Shoqëria nuk ka depozituar dokumentacion në lidhje me këtë kërkesë të rregullores.
- Neni 7, pika 1, gërma “i”, (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve). **Pa plotësuar**. Shoqëria nuk ka depozituar dokumentacion në lidhje me këtë kërkesë të rregullores.
- Neni 7, pika 1, gërma “j”, (Nëse ka patur, listën e transferimeve të kryera më herët nga i njëjti subjekt). **Pa plotësuar**. Në kuadër të kësaj kërkesë të rregullores, shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka patur apo jo listë të aseteve të transferuara më herët ose jo.
- Neni 7, pika 3, (Subjektet konçencionare të licencuar, të cilët aplikojnë për miratimin e transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së konçensionit e pjesët që transferojnë tek përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e Organit shtetëror të autorizuar (MIE) në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve). **Pa plotësuar** Shoqëria nuk është subjekt koncesionar por është mbajtëse e Autorizimit për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaiq “Topojë” me kapacitet 2000 kW; në zonën Sheq Marinas, Bashkinë Fier; Qarku Fier”, e për shkak të këtij statusi, ka detyrimin të përcjellë për dijeni të ERE marrëveshjen e nënshkruar me bankën në lidhje me këtë transferim

dhe informimin e Organit shtetëror të autorizuar (MIE) në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve. Sa vërejtur nga ana e ERE në Kontratën me MIE, rezulton se në nenin 16 “Kufizimet” citohet se: “Mbajtësi i miratimit përfundimtar duhet të marrë pëlqimin paraprak të ministrit në rastin e transferimit të së drejtës së ndërtimit të burimit gjenerues të energjisë tek të tretët plotësisht ose pjesërisht. Në këtë rast palës së tretë do ti transferohen dhe detyrimet apo të drejtat e përcaktuara në këtë kontratë”.

- Neni 7, pika 4, (Kërkesa, informacioni dhe dokumentacioni i bashkëlidhur kërkesës, duhet të jenë të nënshkruar nga personi ose personat e autorizuar nga shoqëria që kanë kompetencën për përfaqësimin e personit mbajtës licence apo të kandidatit të propozuar). ***Plotësuar pjesërisht.***

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për transferim të aseteve (vendosje hipoteke), në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI